



KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHOQËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



Kah është duke shkuar Kosova pas marrëveshjes në Konferencën e Palëve (COP21) në Paris?

*Kosova dhe ndryshimet klimatike:
Koherenca ligjore dhe mangësitë në zbatim*

Autorë: Dina Vllasaliu dhe Learta Hollaj

Redaktor: Fitim Mulolli

Punimi original është i shkruar në gjuhën angleze.

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



Bashkëpunimi Rajonal
Regional Cooperation



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development



Qeverisja Demokratike
Democratic Governance

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
Hyrje.....	5
COP21 dhe Kosova – çfarë duhet bërë Kosova? ²	6
Korniza ligjore dhe e politikave për ndryshimet klimatike në Kosovë.....	8
Progresi në zbatim dhe identifikimi i pengesave.....	10
Përfundime dhe Rekomandime.....	14

Lista e shkurtesave

NK – Ndryshimet Klimatike

SKNK – Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike

COP21 –Konferenca e 21 e Palëve

KE – Komisioni Evropian

TKE – Traktati i Komunitetit të Energjisë

BE – Bashkimi Evropian

AMMK – Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

SMK – Strategjia Mjedisore e Kosovës

SZHEU – Strategjia Zhvillimore për Emetime të Ulëta

MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

VAKZ – Veprimet Adekuate Kombëtare për Zbutje

SKA – Strategjia Kombëtare për Adaptim

PKVBRE – Plani Kombëtar i Veprimit për Burime të Ripërtëritshme të Energjisë

TCT – Termocentrali Termal

KKKBNK – Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Përmbledhje ekzekutive

Diskutimet rreth përpjekjeve për të zbutur dhe t'u adaptuar ndryshimeve klimatike si fenomen global janë mjaft të shpeshta dhe aktuale në shoqërinë e sotme të industrializuar. Samiti fundit e organizuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike në dhjetor të vitit 2015, në Paris, mbledhi liderët nga e mbarë bota për dalë me ide të reja, për të diskutuar dhe për t'u zotuar për synimet e përbashkëta të zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike dhe kontrollimin e ngrohjes globale duke e mbajtur rritjen e temperaturës nën 2 °C.

Pas këtyre diskutimeve, është e domosdoshme të konstatohet progresi i Kosovës përballë iniciativave globale të ndërmarrjes së masave për të zbutur ndikimin e ndryshimeve klimatike si në aspektin e bazës ligjore ashtu edhe progresin në zbatim. Pas hulumtimit të kësaj teme, përmes shqyrtimit të literaturës dhe mbledhjes së të dhënave primare cilësore, është nxjerrë si përfundim se pavarësisht pranisë së një baze relativisht të fuqishme ligjore, ekzistojnë shumë vështirësi që e pengojnë materializimin adekuat të ligjeve dhe strategjive. Për shembull, edhe pse Kosova ka miratuar Strategjinë Kornizë për Ndryshime Klimatike (SKNK), e cila identifikon Veprimet Adekuate Kombëtare për Zbutje (VAKZ) dhe Strategjia Zhvillimore për Emetime të Ulëta (SZHEU), SKNK-së prapëseprapë i mungon absorbimi përmes përpjekjeve të përditshme në sferën shoqërore, ekonomike dhe politike.

Hulumtimi ka identifikuar këto barrierë drejt materializimit adekuat të SKNK-së: 1) mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare, duke marrë parasysh që Kosova ende nuk është palë nënshkruese e traktateve të rëndësishme klimatike, prandaj nuk mund të përfitojë nga ekspertiza dhe financimi i donatorëve ndërkombëtar; 2) mungesa e shkathësive përkatëse njerëzore; 3) mungesa e statistikave në dispozicion për emetimin e gazrave serrë; 4) mos-identifikimi i vitit referues të emetimit të gazrave serrë ose mos-identifikimi në përgjithësi i sektorëve më të ndotur të ekonomisë; dhe 5) neglizhenca e palës qeveritare për të identifikuar masat zbutëse dhe të adaptimit për ndryshimet klimatike si një prej synimeve primare.

Si përgjigje ndaj këtyre, ky punim rekomandon një sërë veprimesh që duhet të ndërmerri vendi për t'i përshtatur synimet kombëtare me ato ndërkombëtare. Pas identifikimit të barrierave, ky punim propozon disa rekomandime të cilat nëse adresohen do të bëjnë të rrjedhshëm procesin e zbatimit të masave zbutëse dhe të adaptimit të identifikuar në SKNK dhe do të sillnin Kosovën një hap më afër përmbushjes së synimeve të veta zhvillimore.

Hyrje

Të kërcënuar nga pasojat serioze, të asaj që i referohemi sot si Ndryshime Klimatike, më 12 dhjetor 2015, liderët e afro 200 vendeve arritën një marrëveshje historike, e cila hapë rrugën për një tranzicion nga ekonomia e nxitur nga lëndët djegëse fosile tek një ekonomi e bazuar në energji të pastër. Edhe pse Ndryshimet Klimatike si fenomen diskutohen përgjatë botës për shumë vite, veprimet e vërteta po marrin formë tek tani pasi që dëshmitë shkencore vazhdimisht sugjerojnë që ndryshimet klimatike janë evidente.

Nga 192 vende të pranishme në Konferencën e Palëve (COP21), të mbajtur në Paris në dhjetor të vitit 2015, Kosova nuk ishte pjesëmarrëse me të drejta të plota, edhe pse përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Kryetari i Komunës së Prishtinës morën pjesë në konferencë. Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe, rrjedhimisht, as anëtare e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), por si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), pritet të përmbushë standardet e përcaktuara në këtë Traktat në lidhje me transformimin e ekonomive të vendeve të Ballkanit Perëndimor në ekonomi me emetim të ulët të karbonit.

Qëllimi kryesor i Marrëveshjes (universale) të Parisit është që temperatura globale në këtë shekull të mbahet nën 2 gradë celsius dhe të nxiten përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës edhe në 1.5 gradë celsius mbi nivelet para-industriale.

Ky punim paraqet zhvillimet që çuan në arritjen e Marrëveshjes COP 21 dhe veçoritë kryesore të saj. Pastaj, përshkruan kornizën ligjore dhe të politikave në Kosovë, përpjekjet për zbatim dhe veprimet tjera të ndërmarra për të luftuar dhe t'iu adaptuar ndryshimeve klimatike. Ky punim po ashtu shqyrton planet e ardhshme dhe politikat konkrete të sugjeruara për t'i realizuar objektivat e parapara me qëllim të kuptimit të progresit dhe identifikimit të mangësive dhe çështjeve që duhet adresuar. Këto të gjetura janë plotësuar me të dhëna të mbledhura përmes intervistave me palët përkatëse me interes, të cilat na kanë ofruar një perspektivë në zhvillimet aktuale në këtë fushë si dhe për të identifikuar pengesat në zbatimin e SKNK-së. Përfundimisht, punimi prezanton konkluzionet dhe një set të rekomandimeve për t'u adresuar nga institucionet e Kosovës.

Rruga drejt COP21

Temperatura aktuale mesatare në botë nga janari i vitit 2016 është shënuar të jetë 1.04 °C më e lartë se mesatarja prej 12 gradëve¹ siç ishte në shekullin 20. Kjo ka shënuar rekord të ri të rritjes më të lartë në temperaturën globale në 137 vitet e fundit¹. Të dhënat shkencore sugjerojnë që shkaktari kryesor i këtij ndryshimi në temperatura është aktiviteti njerëzor.² Të kërcënuar nga aktiviteti njerëzor në rritje dhe çdo herë e më dëmtues, COP21 ka bërë një hap të madh në përpjekjet afatgjata të luftimit të ndryshimeve klimatike. Kjo luftë është institucionalizuar zyrtarisht nga KKKBNK në vitin 1992.² Qëllimi kryesor i KKKBNK-së ishte që, nën kushte të caktuara të stabilizimit dhe reduktimit të emetimit të gazrave serrë në atmosferë të arrihen nivele të cilat nuk

¹ National Centers For Environmental Information: Global Analysis – Janar 2016, e qasshme në: <https://www.ncdc.noaa.gov/sotc/global/201601>

² Causes of Climate Change, Climate Action, e qasshme në: http://ec.europa.eu/clima/change/causes/index_en.htm

do të shkaktonin interferencë të rrezikshme antropogjene.³ Pesë vite më vonë, konferenca e tretë e KKKBNK-së në vitin 1997 miratoi Protokollin e Kjosës, sipas të cilit vendet e industrializuara zotohen të reduktojnë emetimet e tyre të gazrave serrë për 5% gjatë periudhës 2008 – 2012 në krahasim me vitin bazë 1990.⁴ Kjo periudhë e zotimit u shty për vitin 2020 gjatë COP18 të mbajtur në Doha, Katar në vitin 2012, përmes Portës Klimatike të Doha (Doha Climate Gateway).⁵ Porta Klimatike e Doha kishte paraparë edhe krijimin dhe kapitalizimin e Fondit të Gjellbër Klimatik që synonte mbështetjen e vendeve drejt tranzicionit të tyre në ekonomi me lirim të ulët të karbonit.⁵

Brenda viteve 1997 dhe 2013 u mbajtën edhe tri konferenca tjera të rëndësishme të cilat rezultuan me objektiva të cilat sot ofrojnë bazën për Samitin e Parisit. Së pari, COP13 miratoi Planin e Veprimit të Bali në vitin 2007 ku vendet u mobilizuan të identifikojnë Veprimet Adekuate Kombëtare të Zbutjes (VAKZ) në kontekstin e zhvillimit të brendshëm ekonomik të shteteve dhe kapaciteteve të tyre për t'i adaptuar masat ndaj ndryshimeve klimatike.⁶ Së dyti, COP15 në vitin 2009 rezultoi me Marrëveshjen e Kopenhagës e cila parasheh përgatitjen e Strategjitë Zhvillimore për Emetim të Ulëta (SZHEU) për të gjitha palët që nuk janë përfshirë në Aneksin 1 të KKKBNK.⁷ Ndër të tjera, SZHEU përfshinte ndërmarrjen e masave konkrete për reduktimin e emetimit të gazrave serrë dhe implikimet përkatëse si dhe *vetë-monitorimin, raportimin dhe vlerësimin*.⁷ Së fundi, Marrëveshja e Kankunit në vitin 2010 doli me konceptin e transformimit në *ekonomi me emetim të ulët të karbonit*.⁸ Megjithatë, pavarësisht nga samitet vjetore të Konferencës së Palëve, në sesionin e 21-të në Paris, për herë të parë nga bërja e KKKBNK-së, ia doli të lidhë një marrëveshje universale për të mbajtur ngrohjen globale nën 2°C, duke bërë përpjekje të kufizojë rritjen e temperaturës edhe më tutje në 1.5 gradë celsius mbi nivelet para-industriale.⁹

COP21 dhe Kosova – çfarë duhet bërë Kosova?

Me 192 liderë të shteteve, të pranishëm në Konferencën e Palëve (COP21), të organizuar nga KKKBNK, bota pa një përkushtim të unifikuar të më shumë se 95% të ndotësve të botës të cilët së bashku zotohen të luftojnë pasojat e ngrohjes globale dhe të ndërmarrin masa serioze për të reduktuar emetimet përmes rishikimit të planeve të tyre kombëtare për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Konkretisht, Marrëveshja e Parisit mbulon pesë shtylla kryesore të miratuara nga palët nënshkruese, si vijon:

- **Zbutja** – zvogëlimi i temperaturave me shpejtësi të mjaftueshme për të arritur synimin rreth temperaturës;
- Një sistem **transparent** dhe një veprim global i përgjegjshëm klimatik për vërtetuar gjendjen aktuale;
- **Adaptimi** – forcimi i aftësive të vendeve për të adresuar ndikimet klimatike;

³ Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (1992), e qasshme në

http://unfccc.int/files/essential_background/background_publications_htmlpdf/application/pdf/conveng.pdf

⁴ Protokollin e Kjosës (1997), e qasshme në: http://unfccc.int/kyoto_protocol/items/3145.php

⁵ Portës Klimatike e Doha (2012), e qasshme në: http://unfccc.int/key_steps/doha_climate_gateway/items/7389.php

⁶ Plani i Veprimit të Bali (2007), e qasshme në: <http://unfccc.int/resource/docs/2007/cop13/eng/06a01.pdf>

⁷ Marrëveshja e Kopenhagës (2009), e qasshme në: https://unfccc.int/meetings/copenhagen_dec_2009/items/5262.php

⁸ Marrëveshja e Kankunit (2010), e qasshme në: https://unfccc.int/meetings/cancun_nov_2010/items/6005.php


⁹ Sustainable Innovation Forum: Conference of Parties in Paris, 2015, e qasshme në: <http://www.cop21paris.org/about/cop21>

- **Humbja dhe dëmtimi** – forcimi i aftësisë për t'u rimëkëmbur nga ndikimet klimatike;
- **Përkrahja** – përfshirë financimi për shtetet për të ndërtuar të ardhme të pastra dhe të qëndrueshme.¹⁰

Megjithatë, vështirësia kryesore për zbatimin e kësaj marrëveshjeje botërore është se qëllimet e saj nuk paraqesin obligime të detyrueshme ligjore mbi palët nënshkruese. Kjo rrjedh nga fakti se dokumenti nuk merr formën e një traktati zyrtar dhe nuk vë objektiva të detyrueshme ligjore për reduktimin e përdorimit të karbonit. Më tutje, e lë në diskrecion të secilit vend të caktojë objektivat vetanake për reduktim të karbonit. Mekanizmat përkatës të sugjeruar për monitorim të rregullt të progresit si dhe kërkesa për transparencë pritet të luajë në kartën e “turpërimit” (*name and shame*) në rast të mungesës së performancës nga ana e palëve përballë marrëveshjes. Tani mbetet të shihet nëse ky mekanizëm do të jetë i suksesshëm pasi miratimi i marrëveshjes do të jetë e hapur për nënshkrim nga 22 prilli 2016 deri në të njëjtën datë të vitit 2017.

Sido që të jetë, kjo marrëveshje paraqet një fillim premtues dhe është e dizajnuar të kontribuojë drejt qëllimit përfundimtar të luftimit të ngrohjes globale. Tani pyetja që ngritet është se çfarë duhet të bëjë Kosova në këtë drejtim?

Siç është potencuar më parë, Kosova nuk është shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara, dhe rrjedhimisht, as anëtare e KKKBNK-së. Mirëpo, Kosova është palë nënshkruese e TKE-së, të dizajnuar me qëllim të krijimit të një seti të rregullave të detyrueshme ligjore, për të rregulluar tregun e energjisë në rajonin e Evropës Juglindore. Kjo ka krijuar pritje që Kosova të miratojë politika që çojnë në tranzicion drejt ekonomisë me emetim të ulët të karbonit.¹¹ Përmbushja e objektivave të caktuara nën TKE siç është tërheqja e investimeve, krijimi i një tregu të integruar të energjisë, avancimi i sigurisë në furnizim, përmirësimi i gjendjes mjedisore dhe rritja e konkurrencës në nivel rajonal, të gjitha këto janë një obligim ligjor dhe politik për Kosovën. Veç kësaj, Veprimi Klimatik i BE-së, në pakon për energji dhe klimë 2020, ka përfshirë skenarin 20-20-20, sipas të cilit Shtetet Anëtare të BE-së, deri në vitin 2020, duhet të zvogëlojnë emetimet e gazrave serrë për 20%, të rrisin pjesëmarrjen e energjisë së ripërtëritshme me 20%, dhe të përmirësojnë eficiencën e energjisë për 20%.¹² Duke marrë parasysh aspiratat për t'iu bashkuar BE-së, Kosova duhet të respektojë dhe integrojë pakon për klimë dhe energji deri më 2020. Megjithatë, siç është theksuar në Raportin Vjetor të Zbatimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova ka hasur në vështirësi në përmbushjen e qëllimeve të parapara nga pakoja për klimë dhe energji deri me 2020¹¹, në veçanti rreth investimeve në energji të ripërtëritshme sepse siç është potencuar në TKE “fakti që aktualisht nuk ka plane konkrete për investime në hidrocentralin e Zhurit është shqetësuese dhe pa masa shtesë Kosova nuk do të përmbush objektivin e vitit 2020”¹¹. Prandaj,



¹⁰ KKKBNK: Marrëveshja Historike e Parit për Ndryshimet Klimatike, e qasshme në: <http://newsroom.unfccc.int/unfccc-newsroom/finale-cop21/>

¹¹ Traktati i Komunitetit të Energjisë (2005): Kosovë, e qasshme në: https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/AREAS_OF_WORK/Implementation/Kosovo

¹² Komisioni Evropian, Veprimi Klimatik: Pakoja Klimatike dhe e Energjisë 2020, e qasshme në: http://ec.europa.eu/clima/policies/strategies/2020/index_en.htm

diskutimet janë në vazhdim e sipër që afati i vitit 2020 mund të shtyhet në një datë të më vonshme, ndoshta edhe deri me 2030.²⁰

Duke marrë parasysh që një pjesë e madhe e këtyre objektivave përputhen me synimet mjedisore dhe klimatike të Samitit COP, investimet në fushën klimatike jo vetëm që do të përmirësonin mirëqenien e qytetarëve dhe të kontribuonin në zhvillim të qëndrueshëm, por ato do të portretizonin Kosovën si një vend që ka shprehë gatishmëri dhe ka aftësi të ndërmer veprime klimatike dhe t'i bashkohet iniciativave ndërkombëtare. Pasi që karakteri i Marrëveshjes së nënshkruar në Paris nuk është ligjërishit i obligueshëm, dallimi ndërmjet të qenit shtet anëtar/palë nënshkruese apo jo në këtë Marrëveshje nuk do të duhej të mbante larg Kosovën nga përpjekjet për zbatim të synimeve të veta. Qëllimi i konferencës ishte të jetë universale, ambicioze dhe e realizueshme, e balancuar ndërmjet adaptimit dhe zbutjes, e qëndrueshme dhe fleksibile.¹³ Është saktësisht veçoria e fundit që është e rëndësishme për vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara, pasi nocioni i fleksibilitetit siguron që vendet në zhvillim të kenë synime reale për nivelin e tyre të zhvillimit, nevojat dhe specifikat.¹³ Për më tepër, preambula e Marrëveshjes ka krijuar pritje që vendet e zhvilluara të përkrahin ato në zhvillim e sipër. Me fjalë të tjera, vendet 'e pasura' duhet të financojnë ato të 'varfra' për të ecur përpara drejt ekonomisë me emetim të ulët të karbonit dhe të adaptohen ndaj ndryshimeve klimatike në mënyrë proaktive. Kjo pjesë, megjithatë, paraqet pengesën e parë konkrete për Qeverinë e Kosovës në lidhje me përmbushjen e synimeve të ndryshimeve klimatike. Ndonëse përkrahja financiare është e garantuar për shtetet tjera anëtare në zhvillim e sipër ose më pak të zhvilluara të KKKBNK-së, ky nuk është rasti me Kosovën. Sido që të jetë, kjo nuk do të thotë se Kosovës i cenohen mundësitë tjera të financimit të cilat janë në dispozicion për të nga prania e komunitetit ndërkombëtar, që duhet të hulumtohet dhe shfrytëzohet në mënyrë të mençur.

Korniza ligjore dhe e politikave për ndryshimet klimatike në Kosovë

Me qëllim të vlerësimit të pozicionit të Kosovës përballë synimeve të COP21, duhet kuptuar se çfarë masa ka ndërmarrë Kosova deri tani në këtë drejtim. Pas identifikimit dhe analizimit të politikave aktuale, të cilat adresojnë ndryshimet klimatike, mund të thuhet se vendi ka bërë progres të konsiderueshëm në formësimin e bazës ligjore dhe të politikave në lidhje me ndryshimet klimatike. Dokumentet kryesore që rregullojnë fushën dhe adresojnë ndryshimet klimatike në vend janë:

1. **Ligji për Mbrojtje të Mjedisit:** Ligji synon të "harmonizojë dhe promovojë njëkohësisht mirëqenien sociale dhe zhvillimin ekonomik me parimet bazë të mbrojtjes mjedisore në përputhje me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm".¹⁴
2. **Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedis 2011-2015**¹⁵. Objektivi i përgjithshëm i dokumentit është "të zvogëlojë ndotjen në nivele të cilat janë në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet ndërkombëtare."¹⁵ Veç kësaj, dokumenti identifikon prioritetet kryesore të sektorit mjedisor në Kosovë, përfshirë: "a) Plotësimin e legjislacionit mjedisor në përputhje me *acquis* të BE-së; b) Ngritjen e kapaciteteve të palëve përkatëse me interes, c) Zbatimin dhe integrimin

¹³ Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, e qasshme në: <http://www.cop21.gouv.fr/en/learn/what-is-cop21/cop21-the-stakes/>

¹⁴ Ligji për Mbrojtje të Mjedisit Nr. 03/L-025, neni 1, e qasshme në: http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=334&Itemid=28&lang=en

¹⁵ Strategjia Mjedisore e Kosovës dhe Plani i Veprimit Kombëtar Mjedisor (2011-2015), e qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REVISING_and_UPDATING_the_KOSOVO_ENVIRONMENTAL_STRATEGY_\(KES\).pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REVISING_and_UPDATING_the_KOSOVO_ENVIRONMENTAL_STRATEGY_(KES).pdf)

e strategjive mjedisore në sektorët ekonomik; d) Themelimin e një eko fondi; e) Fushatat për vetëdijesim publik; f) Adaptimin e teknologjive të pastërta”¹⁵.

3. **Strategjia Kornizë për Ndryshime Klimatike (SKNK):** Strategjia identifikon masat zbutëse dhe të adaptimit të cilat duhet të ndërmerren Kosova për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.¹⁶

Strategjia Kornizë për Ndryshime Klimatike, paraqet dokumentin më të vonshëm të politikave të miratuara në vitin 2014. Ky dokument, së bashku me dokumentet tjera ligjore dhe të politikave, krijon një bazë të fuqishme për pakon legjislativë “klimatike”. Edhe pse SKNK ende nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, paraqet një hap vendimtar drejt adaptimit dhe zbutjes së ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Nëse i shtojmë këtyre SZHEU dhe Strategjinë Kombëtare të Adaptimit (SKA) e bën tërë kornizën e harmonizuar në parim me synimet e KKKBNK për zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. SZHEU ka dy synime kryesore: 1) Zhvillimin e kapaciteteve të vendit për të përmbushur obligimet e veta që dalin nga KKKBNK dhe BE pasi të bëhet anëtar; dhe 2) Ngadalësimin e rritjes së emetimit të gazrave serrë përmes rritjes së efikasitetit të energjisë, investimeve në energji të ripërtëritshme dhe shfrytëzimit të resurseve natyrore në mënyrë të qëndrueshme.¹⁶ Strategjia Zhvillimore për Emetime të Ulëta (SZHEU) po ashtu identifikon Veprimet Adekuate Kombëtare për Zbutje (VAKZ) që përfshinë:

- 1) Caktimin e një Sistemi Kombëtar të Inventarit për emetimin e gazrave serrë dhe forcimin e raportimit të emetimit të gazrave serrë;
- 2) Zbatimin e Planit të Veprimit për Efikasitet të Energjisë në Kosovë 2010 – 2018;
- 3) Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER) 2011-2020,
- 4) Rritjen e efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike përmes zëvendësimit të Termocentralit Kosova A me Termocentralin ‘Kosova e Re’¹⁷;
- 5) Parandalimin e vetë-ndezjes së linjitet në minierat e thëngjillit në Kosovë;
- 6) Përdorimin e mbeturinave solide të parrezikshme si karburant alternativ në prodhimtarinë industriale;
- 7) Ruajtjen, përgatitjen dhe metodat e aplikimit të plehrave;
- 8) Zbatimin e Strategjisë për Mbrojtje Klimatike në sektorin e pylltarisë në Kosovë.¹⁶

Në anën tjetër, SKA identifikon tri objektiva kryesore për adresimin dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike:

- 1) Përmirësimin e mekanizmave për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, posaçërisht në sektorët e brishtë ndaj ndryshimeve klimatike;
- 2) Avancimin e kapacitetit adaptues të sistemeve natyrore, në veçanti sektorët e brishtë dhe komunitetet, përfshirë grupet e marginalizuara;
- 3) Ngritja e kapaciteteve të akterëve lokal dhe ndërkombëtar dhe palëve me interes të përfshira në zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike.¹⁶

Siç është vërejtur më sipër, SKNK dhe ligjet mjedisore të miratuara janë në përputhje me rezultatet e Samiteve të COP përgjatë viteve, përfshirë Protokollin e Kjosos. Megjithatë, pas COP21, Kosova duhet të rivlerësojë synimet dhe politikat e veta me qëllim të formësimit të mëtutjeshëm të veprimeve të sugjeruara pasi që synimi

¹⁶ Strategjia Kornizë për Ndryshime Klimatike në Kosovë (2014), e qasshme në: http://mmph-rks.org/repository/docs/Climate_Change_Framework_Strategy_19022014_FINAL_717626.pdf

¹⁷ KOSID vazhdimisht ka potencuar faktin që termocentrali ‘Kosova e Re’ në fakt është i panevojshëm për të rritur prodhimin e energjisë në vend jo vetëm se paraqet kërcënim ndaj ndotjes së ambientit por edhe sepse Kosova ka potencial të madh në prodhim të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Më shumë rreth opsioneve energjetike të Kosovës për BRE mund të gjendjen në analizën: http://kosid.org/file/repository/Kammen_RAEL_Sustainable_Energy_Options_for_Kosovo_20_May_2012.pdf.

i paraparë nga Marrëveshja e Parisit kërkon veprime të vendosura nga secili shtet. Krahas kësaj, nëse e krahasojmë me rajonin dhe nëse marrim parasysh se janë bërë vetëm tetë vite nga shpallja e pavarësisë, Kosova ka arritur të vendos një bazë të shëndoshë legjislative dhe është në proces të zhvillimit të një plani të veprimit për të adresuar ndryshimet klimatike. Megjithatë, për të kuptuar efektivitetin e adaptimit dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, duhet të shikohet progresi në zbatim të strategjive të zhvilluara dhe efektet e vërteta zbutëse. Seksioni i mëposhtëm ilustron progresin e bërë në zbatimin e strategjisë si dhe identifikon vështirësitë që pengojnë zbatimin e saj.

Progresi në zbatim dhe identifikimi i pengesave

Edhe pse kornizat ligjore dhe të politikave rreth ndryshimeve klimatike janë në përputhje me synimet e KKKBNK-së dhe legjislacionin e BE-së për ndryshime klimatike, vendi është mbrapa me zbatimin e masave të identifikuara në këto dokumente. VAKZ të identifikuara në SZHEU ende janë duke marrë momentum. Ndërmjet tjerash, vendi ende nuk ka bërë një inventar të emetimit të gazrave serrë; janë bërë hapa të vogël për të investuar në teknologji të pastër, ripërtëritëse ose për të adaptuar teknologjitë më të mira në dispozicion për të prodhuar energji nga linjiti; dhe janë bërë pak investime për të përmirësuar eficiencën e energjisë së vendbanimeve dhe në sektorin publik. Sido që të jetë, duhet cekur se MMPH është në proces të përgatitjes së inventarit të emetimit gazrave serrë për vitin 2013 (për vitin 2012 është krijuar tanimë), i cili do të ndriçojë sektorët më të ndotur të ekonomisë dhe fushat e nevojshme për intervenim. Për më tepër, MMPH është në proces të zhvillimit të Planit të Veprimit për Ndryshime Klimatike dhe komisioni për ndryshime klimatike brenda MMPH-së është themeluar në gusht të vitit 2015 me përfaqësimin më të lartë qeveritar.¹⁸ Tabela më poshtë tregon nivelin e progresit drejt realizimit të masave kryesore në bazë të obligimeve të përcaktuara në dokumentet e listuara dhe përmes SKNK-së.

¹⁸ Qeveria e Kosovës: Themelimi i Komisionit për Ndryshime Klimatike, e qasshme në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_45-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015.pdf, gusht 2015

Të përmbushura

Ligji për Mbrojtje të Mjedisit
Strategjia Mjedisore e Kosovës 2005-2015
Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedis (PKVM)
Strategjia Kornizë për Ndryshime Klimatike
Është hartuar Strategjia Zhvillimore për Emetim të Ulët (SZHEU) është hartuar dhe janë identifikuar Veprimet Adekuate Kombëtare për Zbutje (VAKZ)
Plani Kombëtar i Veprimit është hartuar
Krijimi i inventarit për Gazrat e Liruar nga Serrat për vitin 2012
Themelimi i komisionit ministror për ndryshime klimatike

Në zbatim e sipër

Krijimi i inventarit për Gazrat e Liruar nga Serrat për vitin 2013
Identifikimi i sektorëve më të ndotur të ekonomisë
Rritja e bashkëpunimit në rajon, d.m.th ndër-koneksioni i rrymës elektrike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, që kontribuon në diversifikimin e energjisë për të dy shtetet si dhe sigurinë në furnizim
Investimet në diversifikimin e energjisë, d.m.th burimet e ripërtrirshme të energjisë
Hartimi i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike
Grupi Punues për monitorim të zbatimit të SKNK-së

Ende të pa adresuara

Caktimi i vitit referues për gazrat e serrave
Publikime të rregullta të raporteve me të dhëna dhe atyre vetë-monitoruese për lirim të CO₂ përgjatë viteve
Themelimi i një departamenti për të monitoruar progresin e Strategjisë Kornizë për Ndryshime Klimatike
Krijimi i një eko-fondi që do të mbushej nga tatimet mjedisore të qytetarëve
Përmirësimi i mekanizmave për reduktim të rreziqeve nga fatkeqësitë
Përdorimi i mbeturinave të parrezikshme për prodhimin e karburanteve
Ruajtja, përgatitja dhe metodat e aplikimit të plehrave
Masat kombëtare të ndërmarra për të përmirësuar eficiencën e energjisë
Hulumtim i thellë i potencialit riciklues dhe ripërtrirës të Kosovës
Investime në uljen e lirimeve të CO₂ në sektorët e identifikuar më parë si problematik, përfshirë sektorin e energjisë dhe transportit.

Tabela 1: Progresi i Kosovës drejt zhvillimit dhe zbatimit të masave adaptuese dhe të zbutjes së ndikimeve klimatike

Ajo që del të jetë është se, edhe pse janë bërë hapat fillestar për të materializuar SKNK-në, në këtë fazë pak mund të konstatohet rreth progresit të bërë drejt veprimeve për zbutje të ndryshimeve klimatike ose edhe vetë-monitorimin ose raportimin e rregullt.

Fillimisht, **mos-identifikimi i inventarit të emetimit të gazrave serrë për vitin 2013 ose për vitin referues** po e vështirëson identifikimin e sektorëve më të ndotur, e cila paraqet një pikë që duhet identifikuar para se të ndërmerren masat zbutëse dhe të adaptimit. Për më tepër, **mungesa e statistikave në dispozicion** rreth sektorëve më të ndotur të ekonomisë ose ndryshimi në përqindje përgjatë viteve është një faktor shtesë i cili pengon progresin e Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Këto “dy barriera janë themeli i zbatimit të fuqishëm dhe të suksesshëm të masave të qëndrueshme, të cilat do të zvogëlonin ndikimet e ndryshimeve klimatike në vend.”¹⁹

Mungesa e progresit të konsiderueshëm në këtë fushë konfirmohet edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015 sipas të cilit:

‘Kosova mbetet në një fazë të hershme të harmonizimit me acquis. Nuk ka progres në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike dhe në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti të: 1) krijojë një rrjet të monitorimit mjedisor të ajrit dhe ujit; 2) bëjë planifikim sistematik strategjik për veprimet klimatike.’²⁰

Gjatë përpjekjeve për të konstatuar se pse Kosova është duke hasur në këto barriera të zbatimit, mund të thuhet se mungesa e resurseve financiare dhe kuadrove është arsyeja kryesore. Sa i përket resurseve financiare, siç është theksuar më sipër, duke marrë parasysh se Kosova nuk është palë nënshkruese e KKKBNK-së e as Protokollit të Kjotos, nuk përfiton nga donacionet ndërkombëtare siç është Fondi i Gjellbër Klimatik, pra ka shumë pak fonde të ndara për investime në fushën mjedisore dhe klimatike, që është konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës.¹⁸ Më tutje, siç është potencuar nga përfaqësuesit e MMPH-së, dhe verifikuar nga dokumentacioni zyrtar buxhetor, vetëm rreth 1% e buxhetit vjetor të Kosovës ndahet për MMPH-në.²¹ Një përqindje e tillë tregon se vendi nuk mund të mbështetet në resurset e brendshme për të shtyrë përpara qëllimet e radhitura në SKNK. Prandaj, pasi që masat zbutëse dhe të adaptimit janë të shtrenjta për t’u zbatuar, Kosova është kurthuar në një qark të dokumenteve dhe strategjive që rrallëherë zbatohen. Për më tepër, mungesa e kuadrove me shkathtësi adekuate për të shtyrë përpara dhe për të ofruar ekspertizë për zbatim të VAKZ e përkeqësojnë më tutje perspektivën e Kosovës për të dalë nga ky qark i mos-zbatimit. Një ekspertizë e tillë do të ishte komponent vendimtar i një departamenti përgjegjës për monitorim të zbatimit të SKNK-së. Themelimi i departamentit monitorues brenda MMPH-së do të shënonte një hap vendimtar dhe do të siguronte progresin në zbatim të SKNK-së.¹⁸

E fundit por jo më pak e rëndësishme, pavarësisht nga mungesa e resurseve financiare dhe njerëzore, për të përshpejtuar veprimet klimatike, duhet të reflektohet mbi prioritetet e Qeverisë së Kosovës, pra se a janë ndryshimet klimatike një prej tyre. Pasi që masat zbutëse dhe të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike janë procese afatgjata, politikanët mund të kenë pak stimulim të shtyjnë përpara veprimet të cilat nuk do t’i sjellin rezultate dhe të lavdërohen për arritje brenda mandatit të tyre politik. Për më tepër, ekziston një tendencë e gjerë për të sakrifikuar zhvillimin e qëndrueshëm për zhvillim ekonomik, pa kushte, me arsyetimin se mirëqenia ekonomike dhe shoqërore e qytetarëve dhe veprimet për të luftuar varfërinë dhe papunësinë mbizotërojnë mbi shqetësimet rreth ndryshimeve klimatike. Fakti që Qeveria e Kosovës nuk e ka të radhitur si një prej prioriteteve adresimin e ndryshimeve klimatike në agjendën e saj politike konfirmohet edhe nga Zyrtari i Lartë për Planifikim të Politikave në Zyrën për Planifikim Strategjik të Kryeministrit të Kosovës, sipas të cilit Qeveria është më

¹⁹ Vjosa Beqaj, Udhëheqëse e Departamentit të Politikave Sektoriale në MIE, Intervista e dhënë Institutit për Politikë Zhvillimore (INDEP), tetor 2015.

²⁰ Raporti i Progresit i Kosovës për vitin 2015, Komisioni Evropian, e qasshme në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

²¹ Muhamet Malsiu, Udhëheqës i Inspektoratit Mjedisor në MMPH, intervista e dhënë Institutit për Politikë Zhvillimore (INDEP), tetor 2015.

shumë e fokusuar në zbutjen e varfërisë dhe papunësisë, zhvillimin ekonomik dhe zgjidhjen e tensioneve aktuale politike, pra mund të sakrifikojë veprimet klimatike në këtë kohë.²²

Përfundimisht, ajo që është më shqetësuese është se pavarësisht nga ekzistenca e mjeteve ligjore dhe mekanizmave premtues, zhvillimi i sektorit të energjisë në Kosovë është duke marrë një kahje tjetër nga ajo që pjesa tjetër e botës është zotuar. Me vendimin e kohëve të fundit të Qeverisë dhe nënshkrimin e marrëveshjes (Memorandumit të Mirëkuptimit) me 18 dhjetor 2015, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe investitorit të ri, Kosova planifikon të ndërtojë një termocentral me kapacitet 500 MW me linjit për të siguruar energji në planin afatgjatë në vend. Një veprim i tillë është një paradoks posaçërisht në këtë kohë kur Marrëveshja e Parisit shihet si “një sinjal për tregjet globale financiare dhe të energjisë, për të bërë shmangje nga investimi në thëngjill, naftë dhe gaz si burime primare të energjisë drejt burimeve të energjisë me zero-karbon siç kanë energjia me erë, solare, hidro dhe biomasa”.²³ Në anën tjetër, nuk duhet harruar që emetimet nga dy termocentralet ekzistuese, Kosova A dhe Kosova B, së bashku, janë 74 herë më të larta sesa niveli i lejuar me standarde të BE-së, të parapara nga Direktiva e Komisionit Evropian për Uzina me Djegie të Lartë.²⁴ Si të tilla, këto dy termocentralet janë ‘armiqtë’ kryesor të mjedisit dhe ndotësit më të mëdhenj në vend, prandaj nevoja për intervenim të menjëhershëm në këtë drejtim është shumë e domosdoshme.

²² Vedat Sagonjeva, intervista e dhënë Institutit për Politikë Zhvillimore (INDEP), tetor 2015.

²³ Nations Approve Landmark Climate Accord in Paris, The New York Times, December 2015, e qasshme në: <http://www.nytimes.com/2015/12/13/world/europe/climate-change-accord-paris.html>

²⁴ Kosova: Analiza Mjedisore e Vendit – Vlerësimi i Kostos së Degradimit Mjedisor, Shqyrtim institucional dhe Shqyrtim i Shpenzimeve Publike në Mjedis, Banka Botërore, e qasshme në: <http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/KosovoCEA.pdf>

Konkluzioni dhe Rekomandimet

Njëjtë sikur është rasti në shumë fusha tjera, nuk është befasi të thuhet se baza ligjore në Kosovë që aplikohet për politikën dhe veprimet rreth ndryshimeve klimatike janë në përputhje *acquis* të BE-së dhe rezultatet e Konferencës së Palëve. Pas miratimit të SKNK-së, që përfshin planin e veprimit dhe identifikon NAMA që duhet ndërmarrë për të zbutur ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e emetimeve të emetimit të gazrave serrë në atmosferë, Qeveria e Kosovës ka vendosur një bazë të mirë veprimi në këtë drejtim. Megjithatë, ekziston një zbrastëritje ndërmjet legjislacionit ekzistues e politikave me zbatimin.

Për më tepër, ndryshimet klimatike vazhdojnë të mbesin një temë e marginalizuar në Kosovë pasi që vendi është duke u ballafaquar me probleme serioze si papunësia e lartë dhe varfëria. Sido që të jetë, të nxitur nga rezultatet e COP21 dhe vetë Marrëveshja, është një obligim moral dhe shoqëror për t'u përkushtuar më seriozisht drejt zbatimit të masave të zotuar me qëllim të përmbushjes së synimeve të përcaktuara. Duke marrë parasysh të gjitha pengesat e identifikuara, ky punim propozon një set të masave të cilat do të duhej të sigurojnë progres të konsiderueshëm drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik duke respektuar të drejtat e njeriut dhe konsideratat adekuate për mbrojtje të mjedisit.

Në përputhje me të gjeturat dhe argumentet e elaboruara më sipër, ky punim propozon rekomandimet e mëposhtme të cilat do të ngushtonin dallimin ndërmjet legjislacionit të miratuar aktual dhe zbatimit të atij legjislacioni:

1. **Bërja e inventarit të emetimit të gazrave serrë për vitin 2013 dhe identifikimi i vitit referues (bazë).** Inventari i emetimit të gazrave serrë për vitin 2013 do të ofrojë një model të qartë të aktiviteteve ekonomike më ndotëse dhe emetimet e tyre përkatëse të CO₂, pra është obligim primar që duhet të përmbushet para bërjes së çfarëdo intervenimi në sektorët ekonomik. Po ashtu, është vendimtare të përcaktohet një vit referues për gazrat serrë përballë të cilit do të krahasohej përqindja e ngritjes apo rënies së emetimeve. Protokollin i Kjotos ka identifikuar vitin 1990 (ose 1995 si alternativë) si vit bazë i përgjithshëm për shtetet e përfshira, por ka lejuar fleksibilitet në miratim që vendet të caktojnë vet vitin bazë. Deri tani, Hungaria, Bullgaria, Sllovenia, Polonia dhe Romania kanë caktuar vite të ndryshme bazë, varësisht nga niveli i zhvillimit dhe tranzicionit në ekonomi të tregut. Kosova mund të ndjekë të njëjtin shteg, duke identifikuar vitin bazë sipas faktorëve të lartpërmendur. Në të vërtetë, SKNK, brenda një prej fletave intervenuese të SZHEU, ka identifikuar Agjensionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe MMPH-në si institucionet përgjegjëse për bërjen e inventarit të emetimit të gazrave serrë dhe fillimit të raportimit të rregullt në periudhën 2014 – 2020.
2. **AMMK të përgatit raporte të rregullta vetë-monitoruese dhe vlerësuese** siç është obliguar nga SZHEU në SKNK. Për të siguruar një raportim të rregullt dhe të standardizuar, Strategjia Zhvillimore për Emetime të Ulëta duhet të sigurojë bërjen e identifikimit të afateve kohore për raporte si dhe dispozitave në bazë të të cilave do të dokumentohen monitorimi dhe vlerësimet. Raportet e rregullta dhe të standardizuara do të ofrojnë azhurnim të vazhdueshëm të drejtimit në të cilin po shkon Kosova rreth ndryshimeve klimatike dhe do të jetë një indikator i fektivitetit të veprimeve bashkëkohore mbi zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike.
3. **Themelimi i një departamenti për të monitoruar progresin e zbatimit të Strategjisë Kornizë për Ndryshime Klimatike dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave të miratuara.** Kosova edhe ashtu është e obliguar nën Traktatin e Komunitetit për Energji të përgatis raporte dyvjeçare për inventarin e emetimit të gazrave serrë dhe azhurnimet rreth masave zbutëse dhe të adaptimit. Raportet e tilla janë vitale për të matur progresin në vend dhe për të identifikuar hapat e nevojshëm që duhet

ndërmarr për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Po ashtu, raportet e rregullta çojnë në transparencë si para palëve me interes vendore ashtu edhe ndërkombëtare të përfshira ose të prekura nga masat e zbutjes ose adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike.

4. **Rishikimi i planeve aktuale të Ndryshimeve Klimatike për t'i vënë në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit** – Pasi është përcaktuar që Kosova ka krijuar bazë të favorshme për të filluar adresimin e problemeve të ndryshimeve klimatike, pas nënshkrimit të Marrëveshjes në Paris, është pothuajse imperativ të bëhet rishikimi i këtyre politikave dhe synimeve për t'i përshtatur me pjesën tjetër të botës drejt përmbushjes së objektivit të caktuar prej 2°C. Kjo është posaçërisht me rëndësi tani që vendi ka vendosur të investojë në ndërtimin e termocentralit të ri. Në këtë fazë, pasi që nuk është konsideruar ideja e heqjes dorë nga investimi në thëngjill për sektorin e energjisë (një praktikë e përqaftuar përreth botës), Qeveria duhet të ndërmerr të gjitha masat paraprake për të siguruar që investitori të bëjë investimet në teknologjinë më të re dhe miqësore ndaj mjedisit duke i përmbushur standardet më të larta për reduktim të ndotjes potenciale.
5. **Themelimi i një eko fondi** që do të financohej nga tatimet mjedisore të qytetarëve të Kosovës. Fondi, po ashtu i propozuar nën SKNK, do të themelohej ndaras prej buxhetit kombëtar të vendit dhe do të lehtësonte problemin e fondeve duke alokuar një shumë të konsiderueshme të financave vendore për zbatim të planit të veprimit të identifikuar nën strategjinë kornizë. INDEP tanimë ka analizuar mundësinë e themelimit të një fondi të veçantë për të përmirësuar eficiencën e sektorit të energjisë.²⁵ Ngjashëm, eko fondi do të ishte një qasje e përgjithshme në krijimin e një fondi monetar për të përfshirë masat e zbutjes dhe të adaptimit brenda çështjeve mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike.
6. **Çështjet mjedisore të bëhen prioritet në nivel institucional.** Aktualisht, Qeveria e Kosovës nuk i ka domosdoshmërisht masat e zbutjes dhe të adaptimit klimatik si prioritet në agjendën politike.²⁶ Megjithatë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që Qeveria të bëjë prioritet zhvillimin e qëndrueshëm bashkë me zhvillimin ekonomik me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare dhe synimit të anëtarësimit në Kombe të Bashkuara dhe Bashkim Evropian. Më tutje, jeta në një mjedis të shëndetshëm është e drejtë e çdo qytetari të Kosovës, pasi që ajri i pastër tregon mirëqenien e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Kur jemi këtu, Qeveria duhet të adresojë seriozisht ardhmërinë e dy termocentraleve ekzistuese, posaçërisht Kosova A – një termocentral i vjetër i destinuar për dekomisionim deri në vitin 2017. Së fundi, si rrjedhojë e rritjes së vetëdijes së qytetarëve në botë, zhvillimi i qëndrueshëm është bërë faktor konkurrues në shoqërinë e sotme çdo herë e më të gjelbër.
7. **Rritja e investimeve kapitale në burimet e pastra të energjisë.** Pasi që vendi duhet të përmbush objektivat 20-20-20, të përcaktuara nga Traktati i Komunitetit të Energjisë deri më 2020 (tani me gjasë të shtyra deri më 2030), investimi në burime të energjisë së pastër jo vetëm që do të diversifikonte energjinë nga karboni drejt zgjedhjeve më të pastra, por edhe do të kontribuonte drejt zbutjes së efektit të ndryshimeve klimatike, si dhe në përmbushjen e synimit të klasifikimit të karbonit si një aset të “izoluar”. Duke ditur se Kosovës i mungojnë resurset financiare për rritjen e investimeve kapitale, këto opsione mund të ndihmojnë në rritjen e fondeve monetare: 1) themelimi i një eko fondi si subjekt i ndarë nga buxheti kombëtar, 2) Lidhja e partneriteteve publiko-private (PPP) me ndërmarrje ndërkombëtare të përfshira në instalimet e energjisë së ripërtrirshme ose përmirësime të eficiencës së energjisë, dhe 3) Tërheqja e investimeve të drejtpërdrejta të huaja në sektorin e energjisë së ripërtërishme duke vlerësuar paraprakisht potencialin e Kosovës në këtë drejtim.

²⁵ INDEP: Financimi i Eficiencës së Energjisë në Kosovë: Përfitimet dhe Barrierat, fq. 35 (2015, e qasshme në: http://www.indep.info/documents/1064_INDEP_Energy%20Efficiency%20Fund%20-%20Kosovo%20Policy%20Paper.pdf)

²⁶ Vedat Sagonjeva, intervista e dhënë Institutit për Politikë Zhvillimore (INDEP), tetor 2015

8. Rritja e bashkëpunimit me rajonin për të zbutur dhe adaptuar ndaj ndryshimeve klimatike.

Kjo është posaçërisht vendimtare në sektorin e energjisë ku Kosova do të mund të përfitonte nga pasuritë natyrore hidrike të Shqipërisë, por nuk është e limituar vetëm në sektorin e energjisë. Ky bashkëpunim mund të jetë i dobishëm edhe në shkëmbim të tregut të “karbonit” pas bërjes së inventarit të emetimit të gazrave serrë, rajoni mund të angazhohet në tregtimin e emetimit të gazrave serrë me vendet tjera. Koncepti i tregtisë së emetimit, së pari i plasuar me nenin 17 të Protokollit të Kjotos, i mundëson një vendi që nuk ka arritur majën e gazrave serrë në një vit, të “shesë” pjesën e mbetur një vendi të interesuar e cila i ka tejkaluar objektivat e emetimit të gazrave serrë brenda atij viti.²⁷ Në këtë mënyrë, nëse Kosova i kalon objektivat e emetimit të gazrave serrë në një vit dhe dëshiron të industrializohet tutje por nuk mund ta bëjë këtë pa liruuar më shumë gazra në atmosferë, atëherë mund të bëjë tregti të emetimit me një shtet që nuk e ka arritur majën e emetimit në një vit.

²⁷ Protokollin i Kjoto, neni 17 (1997), e qasshme në: http://unfccc.int/kyoto_protocol/items/3145.php